

VENDIM
Nr.932, datë 2.7.2008

PËR PËRCAKTIMIN E PAGAVE DHE TË SHITESAVE MBI PAGË TË PUNONJËSVE SHQIPTARË, PËR KOHËN, QË SHËRBEJNË SI OFICERË KONTAKTI, PRANË MINISTRIVË TË BRENDSHME HOMOLOGE TË SHTETEVE TË NDRYSHME, TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 47 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit shqiptarë të Ministrisë së Brendshme, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë, për kohën, që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme, homologe të shteteve të ndryshme, të trajtohen me pagë për gradë dhe shtesë për përfaqësim, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Për efekt të këtij trajtimi, paga e oficerëve të kontaktit të Ministrisë së Brendshme njësohet me pagën e gradës “Këshilltar”, në shërbimin e jashtëm.

2. Oficerët e kontaktit, për kohën, që shërbejnë pranë ministrive të brendshme, homologe të shteteve të ndryshme, përfitojnë edhe kompensim për koston e jetesës, si më poshtë vijon:

- 300 euro/USD, për vendet e grupit të parë;
- 260 euro/USD, për vendet e grupit të dytë;
- 230 euro/USD, për vendet e grupit të tretë;
- 200 euro/USD, për vendet e grupit të katërt;
- 150 euro/USD, për vendet e grupit të pestë.

Kategorizimi i përfaqësive, për efekt të koston e jetesës, është sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Trajtimi me pagë, sipas këtij vendimi, i oficerit të kontaktit fillon nga data e mbërritjes së tij në përfaqësi. Deri në këtë çast ai vazhdon të trajtohet me pagën e vendit të tij të mëparshëm.

4. Paga mujore i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale, sipas legjislacionit në fuqi.

Në bazë të pagës mujore do të paguhet edhe detyrimet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

5. Paga mujore i nënshtrohet rishikimit, në të njëjtën formë, si të gjitha kategoritë e tjera të pagave në Republikën e Shqipërisë.

6. Pagat për oficerët e kontaktit, që shërbejnë në vendet e Europës, bëhen në euro, ndërsa për vendet e tjera, në USD.

7. Pika 5 e vendimit nr.318, datë 4.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për vendosjen e oficerëve të kontaktit të Ministrisë së Rendit Publik pranë ministrive homologe të Greqisë, Italisë, Turqisë dhe UNMIK-ut, Kosovë, të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.

8. Ministria e Brendshme, brenda fondeve buxhetore vjetore, të parashikuara në ligjin e buxhetit, të vitit përkatës kalendarik, të përballojë shpenzimet për pagat e oficerëve të kontaktit.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**PAGA MUJORE E OFICERËVE TË KONTAKTIT TË MINISTRISË SË BRENDASHME,
TË ATASHUAR NË PËRFAQËSITË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË**

Pozicioni	Paga mujore	
	Paga bazë mujore (në euro dhe në dollarë)	Shtesë për përfaqësimin në %
Oficer kontakti	750 euro 950 dollarë (USD)	40%

Lidhja nr.2

KATEGORIZIMI NË BAZË TË KOSTOS SË JETESËS

300 euro/\$	260 euro/\$	230 euro/\$	200 euro/\$	150 euro/\$
Londër	Vjenë	Bruksel	Zagreb	Shkup
Gjenevë	Uashington	NATO	Kajro	Bukuresht
Moskë	Paris	Athinë	Janinë	Prishtinë
Kopenhagë	Romë	Ankara	Bari	Sofie
Bernë	Strasburg	Hagë	Kuala Lumpur	Podgoricë
Pekin	Berlin	Stokholm	Raid	Buenos Aires
Tokio	Madrid	Varshavë		Bukuresht
Milano	Ottava	Budapest		
Stamboll		Pragë		
		Beograd		
		Selanik		
		Tel Aviv		
		EUROPOL		